

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

Nr \_\_\_\_ prot

Selenice. \_\_\_\_\_2023

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Materiale ndertimi”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Materiale Ndertimi-44110000-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 16,666,666 ( Gjashtembedhjete milion e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë leke ) pa TVSH**

**Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit referuar rregullave të prokurimit publik në nenin 76 të VKM-se. konkretisht një pjesë e zerave të preventivit u moren nga cmimet zyrtare të publikuara në manualin e cmimeve sipas VKM- 629 date 15.07.2015**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia **Selenice** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** *kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022**, ku vlera e xhiros për 3 (*tre*) vitet e fundit duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,.

**2.2.2** Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin **2021** dhe **2022** për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

#### **2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.2.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara*

në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar . Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

---

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **10 (Dhjetë) punonjës** për periudhën e fundit **3 (tre)** mujore nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për vërtetimin e këtij kushti të paraqiten:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar minimumi **2(dy)** shofer kamionash , të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi apo me qera një ambient për prodhimin e betonit ( të licensuar) të garantojnë furnizim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit , I cili të ndodhet në një distance jo më shumë se 10 km nga Fshati Peshkepi.
- b. Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH ISO/IEC 17025:2017 ”Kërkesa të përgjithshme për Kopetencën e Laboratoreve Testues dhe Kalibrues”.

**2.3.8 (Makinëri, Pajisje)**

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Mjetet	Sasia	Pronësia
Kamion deri ne 7 ton	2copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	5 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera

**-Per mjetet e transportit duhet te paraqiten:ne rast se jane ne pronesi** dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit ( leja e qarkullimit), certifikata e pronesise, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

**Kur mjetet jane me qera duhet te paraqitet** :kontrata e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion operatori ekonomik per te permbushur kontraten te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...*”, sjellim ne vemendje se:

- **Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajiseje të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.**
- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimit e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

□ **Për vërtetimin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, të paraqiten:**

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie

original ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).

- 3- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie original ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*).
- 4- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie original ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*).
- 5- Operatori ekonomik nuk duhet t'i ketë kapacitetet teknike të angazhuara në kontratat të tjera dhe nuk duhet të jenë të deklarurara në procedurë të shpallura fituese (**deklaratë me shkrim nga Administratori i Shoqërisë**)

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Klevis Bedinaj

Dule Dulaj